

## Duke Ndhimuar Femijen Tuaj te Mesoje Dy Gjuhe

Shume femije ne United States, po mesojne sapo lindin dy gjuhe ne te njejten kohe – gjuhen ametare te familjes se tyre dhe Anglisht. Te gjithë femijet kane lindur me potencialin per te mesuar dy gjuhe. Prinderit mund te kene frike, se femijet e tyre do te ngatërrohen, duke mesuar me teper se nje gjuhe. Megjithate, burimet kane percaktuar, se femijet qe rriten duke mesuar dy gjuhe, kane shume avantazhe. Femijet qe kuptojne me thelle rreth dy kulturave, fitojne aftesi mendimi me te forta dhe kane nje sens te pergjithshem me te mire per gjuhen. Ky **Buletin** diskuton, se si familjet mund te ndihmojne femijet e tyre te cilet mesojne dy gjuhe, ne ndertimin e aftesive te duhura, per te qene lexues dhe studiues te sukseshem kur te fillojne shkollen.



### Se Pari, Le te Flasim

Fillo te flasesh menjehere! Flit Spanjisht. Flit Anglisht. Flit Somalisht. *Flit ne gjuhen qe eshte me e kollajshme per ty.* Nga lindja deri ne moshen tre vjec, truri i femijes rritet me shpejt se cdo kohe tjeter. Te flasesh me femijen gjate ketyre viteve, eshte gjeja me e rendesishme qe nje prind mund te beje, sepse kjo ndihmon ne ndertimin sa me heret te pjeses me te madhe te trurit. Nuk ka rendesi gjuha qe prinderit flasin me femijet e tyre. Thjeshte duke folur dhe

degjuar femijen, ata bejne nje pune shume te madhe, e cila ndikon gjate gjithë jetes se femijes.

Nje studim i gjere ka konstatuar, se femijet e rritur ne nje familje e cila i ka folur me shpesh femijeve te tyre deri ne moshe tre vjec, kane nje fjalor dy here me te gjere se femijet e rritur ne nje familje, qe i ka folur rralle femijeve te saj. Sa me shume fjale te perdorin prinderit dhe sa me shpesh ti flasin foshnjeve te tyre, aq me i gjere do te jete fjalori i femijeve ne moshen 3 vjec. Sa me i gjere te jete

fjalori i femijes ne moshen 3 vjec, aq me i gjere do te jete ai ne klasen e 5 te. Kjo do te vazhdoje gjate gjithë kohes qe femija eshte ne shkollë.

Nuk eshte e mjaftueshme, vetem ta ulesh femijen perpara televizorit. Femijet duhet te bashkeveprojne me te tjeret, per te marre vesh se cfare ndodh, ne menyre qe te mund te lidhin fjalet qe ata degjojne me eksperienat e tyre. *Bashkeveprimet e ndjeshme me te rriturit ndihmojne me shume se cfardo lloj lodre, TV apo DVD, ne zhvillimin e truri te femijes.*

### Keshilla per te Folurin...

- **Flit per ngjarjet e perditshme.** E folura ndihmon bebet dhe femijet e vegjel per te lidhur fjalet me eksperienat e tyre,
  - Kur e vesh femijen, pershkruaj cdo gje qe i vesh— qe nga pelenat, xhaketa, pantallonat, kepuçet dhe corapet, deri tek ngjyrat, butonat dhe zinxhret
  - Kur je ne autobuz, makine apo duke ecur, flit rreth gjerave qe shikon dhe ndjen. Lexo lajmerime, trego numra, germa ose ngjyra te caktuara.
- **E folura e bebes eshte gje e mire.** Ne fillim, perdor fjale dhe prekje me dore per t'ju pergjigjur te qares se femijes. Kur femija fillon te belbezoje, vazhdo pergjigju me fjale, gjeste, tinguj. Femijet qe reagojne, fitojne konfidence dhe kenaqesi per gjuhe.
- **Flit me fjali te verteta.** Perdor gjithashtu fjale te medha, edhe pse e di qe femija nuk do ti kuptoje ato. Perdor fjale me te thjeshta per te ndihmuar femijen qe ti kuptoje ato. Flit ngadale, perdor gjeste. Duke degjuar fjale te reja, femija e pasuron fjalorin e tij/saj.
- **Trego histori.** Historite mund te permbajne fjale, qe mund te mos perdoren ne jeten e perditshme.
- **Bej pyetje dhe bisedo.** Duke u rritur femija, vere ate te tregoje nje ngjarje ose te perserisi nje ngjarje familjare. Inkurajo femijen qe te flase me ju per shoket, eksperienat dhe idete e tij/saj.
- **Gezohu.** Perdorimi i rimes, fjalet e veshtira, dhe forma te tjera te fjaleve ne gjuhen ametare, e ndihmojne femijen tuaj per te mesuar rreth tingujve.

## Lexoi Femijes per te Zgjeruar Boten e tij

Kur i jepni femijes fjalet, ju i keni dhene boten. Nje nga rruget me te mira per te zgjeruar fjalorin e femijes, jane librat. Femijeve, te cileve u eshte lexuar qe kur kane lindur, pavaresisht nga gjuha, jane me te suksesshem kur mesojne te lexojne. Mbani mend, qe aftesite e leximit te mesuara ne nje gjuhe, mund te transmetohen ne nje gjuhe tjeter. Sa me te forta te jene aftesite e femijes ne lexim dhe gjuhen e tij ametare, aq me te forta do te jene ato ne mesimin e nje gjuhe te dyte.

Vitet e vegjelise kalojne shume shpejt, por ato ndikojne gjate gjithes jetes se femijes. Kur ju krijoni cdo dite nje ambient te pasur ne gjuhe nepermjet bisedave, ngjarjeve, lojra fjalesh, rimes, kenges dhe leximit, ju e pergatisni femijen tuaj per te mesuar dhe patur sukses ne te ardhmen. Pra, vazhdo kenaqu - bisedo, lexo, buzeqesh, kendo dhe luaj me femijen tend. Duke i folur e lexuar femijes, si dhe duke folur e lexuar sebashku me te, eshte pergatitja me mire qe mund ti jepni femijes per te qene gati per fillimin e shkolles dhe per te qene i etur per te mesuar.

## Rregullat e Leximit...

- **Fillo leximin menjehere sapo femija eshte foshnje.** Lexo cdo dite. Lexo me shrehje te fytres dhe perdor zera te ndryshem. Mbaj me vete libra per te lexuar kudo qe shkon.
- **Nuk lexon? Mos u shqetes!** Nuk eshte e domosdoshme te lexoni, qe ta ndihmoni femijen per te mesuar rreth leximit dhe te pelqeje librat. Bisedo per pikturat dhe historite qe ata tregojne. Ftoje femijen qe te tregojte pikturat dhe te ktheje fleten e librit. Bisedo me femijen rreth atyre qe ju shikoni neper flete.
- **Lexo me femijen.** Perdor rruge te ndryshme, qe femija juaj te marre pjese ne veprime. Inkurajo femijen, qe te "lexoje" ose t'ju tregojte nje ngjarje. Kerko qe femija te tregojte nje fotografi sipas emrit qe i keni vene ju, ose kerko qe ai/ajo t'i verre vete nje emer. Kerko qe femija te marre me mend se si vazhdon ngjarja. Ne qofte se ke mundesi, ndihmoje femijen qe te njohi shkronjat dhe t'i lidhi ato me tingujt, qe ju te dy leshoni.

## Duke Folur dhe Lexuar

### Rruge te Provuara, per te Ndhimuar Femijen Tuaj te Mesoje Dy Gjuhe

Ky **Buletin** nenvizon disa burime te koheve te fundit, te cilat tregojne per nje ndryshim te madh qe kane bere femijet, te cilet rriten duke mesuar dy gjuhe ne te njejten kohe. Ne kete **Buletin**, ne i quajme keta femije si "studiues te gjuhes se dyfishte." Eshte e rendesishme per prinderit dhe anetaret e familjes, te cilet nuk flasin Anglisht, qe te kuptojne, se aftesite e hershme te gjuhes qe femijet kane mesuar ne gjuhen e tyre ametare, i ndihmojne ata te mesojne dhe kuptojne Anglisht.

#### Burimet

**Pergatitu te Lexosh!** Ky Web site ka per qellim te ndihmoje prinderit, te cilet flasin - Spanjisht, per te ndertuar aftesite e te mesuarit dhe shkrim - kendim te femijeve te tyre parashkollore dhe te kopshtit. Per te mesuar me teper, vizito [http://getreadytoread.org/index.php?option=com\\_content&task=view&id=98&Itemid=107](http://getreadytoread.org/index.php?option=com_content&task=view&id=98&Itemid=107)

**¡Colorín Colorado!** Ky Web site dy gjuhesh, siguron informacion per prinderit dhe familjet, te cilin ata mund ta perdorin per te ndihmuar femijet e tyre, qe te behen lexues te mire dhe studente te suksesshem. Per me teper, vizito <http://www.colorincolorado.org/families>



Non-Profit  
U.S. Postage  
PAID  
BOSTON, MA  
PERMIT NO.  
50539

Massachusetts PIRC  
Federation for Children with Special Needs  
1135 Tremont Street, Suite 420  
Boston, MA 02120

Parents' PLACE Bulletin is funded by the U.S. Department of Education, Office of Innovation and Improvement. Parent Information and Resource Center program, under Grant #84.310A. The views and opinions herein do not necessarily reflect those of the U.S. Department of Education. This Bulletin was written by Janet R. Vohs, Mass. PIRC staff. We encourage copying of this newsletter to distribute to parents and families. Permission is granted to reprint this newsletter in whole or in part. Please credit Parents' PLACE Bulletin, Massachusetts PIRC, Federation for Children with Special Needs, and contact us at [masspirc@fcsn.org](mailto:masspirc@fcsn.org) to indicate the number of copies disseminated.  
© Federation for Children with Special Needs, 0310.

Parents' PLACE Bulletin